- Sipërfaqja e konsiderueshme e pronës, plotëson kërkesat për ndërtimin e një kompleksi shërbimesh me disa struktura si: (objekt zyra 2 kat, magazinë, shesh depozitimi) si dhe rrugë kalimi ndërmjet tyre për kalimin e mjeteve.
- Prona ofron mundësi për të realizuar konfigurimin më të mirë të mundshëm, për qëllimet e funksionalitetit të qendrës.
- Me VKM nr. 852, datë 24.12.2019 aktualisht prona është në administrim të Albgaz Sh.a.

Në sipërfaqen e mësipërme, Projektuesi duhet që në një fragment me sipërfaqe 3,000 - 5,000 m² të truallit në dispozicion të sigurojë vendosjen e objekteve të mëposhtëme :

- | | |
|--|-------------------------------------|
| - Godina administrative 2 katëshe: | Sip 300 m ² (gjurma) |
| - Magazinë të mbuluar: | Sip 400 m ² |
| - Shesh depozitimi të jashtëm (me strehë): | Sip 200-250 m ² |
| - Shesh depozitimi të jashtëm 2: | Sip 50 m ² (mbeturinash) |
| - Vend parkime automjeteve të gjata: | Njësi 2 - 4 |
| - Vend parkime automjeteve të vogla: | Njësi 10 -15 |

- Rugë qarkullimi të brendshme që të lejojnë hyrjen në kompleks, aksesin në sheshe dhe daljen nga kompleksi të automjeteve të gjata plus hyrjen, parkimin dhe daljen e automjeteve të vogla.
- Rugë hyrje, dalje dhe qarkullimi të brendshëm këmbësorësh
- Zona të gjelbëruara

2. ZYRA (Godinë administrative 2 (dy) katëshe

Me qëllimin për krijimin e ambienteve që plotësojnë kërkesat në drejtim të funksionalitetit si dhe duke pasur parasysh shërbimet që do të ofrohen në to, është menduar që godina që do të shërbejë si zyrë, do të jetë një ndërtesë, dy (2) katëshe me një sipërfaqe gjurme rreth 300.00 m². Struktura e objektit do të jetë prej skeleti beton/ arme me mure prej tulle. Kjo ndërtesë do të ketë hapësira me karakter të ndryshëm (administrativ, akomodues, ambiente shërbimi, etj).

- Ndërtesa e zyrave do të jetë një ndërtim i ri, dhe duhet të ketë hapësira të mjaftueshme për aktivitetin administrativ.
- Vendndodhja e objektit duhet të jetë në një pozicion qendror, dhe e lidhur në mënyrë harmonike me objektet e tjera që do të jenë pjesë e kompleksit të shërbimeve (ambientet e magazinimit, sheshet e depozitimit, rrugët e qarkullimit, parkimet).
- Hapësirat e lira të truallit duhet ti nënshtrohen rikonceptimit arkitektonik, si dhe duhet të përmbajnë sipërfaqe të gjelbërta, çlodhëse dhe rekreative. Këto hapësira duhet të ndërlidhen në mënyrë organike me hapësirat e tjera të kompleksit të shërbimeve.
- Objekti i zyrave duhet të jetë pjesë e një masterplani të përgjithshëm të pronës ku të gjitha objektet e propozuara duhet të jenë në harmoni me objektet e tjera. Zgjidhjet duhet të përputhen me kondicionet urbane të zonës.

KËRKESA FUNKSIONALE PËR NDËRTESËN E ZYRAVE

• Kati përdhe

Hapësira e katit përdhe do të organizohet në dy zona kryesore: *një zonë për qëllime shërbimi* ku do të vendosen dhomat e ndërrimit për personelin, dushet dhe tualetet si dhe *një zonë* që do të shërbejë *për zyra* ku do të vendosen salla e mbledhjeve, dy laboratorë si dhe një ambient për serverin.

Në katin përdhe parashikohen gjithsej 6 (gjashtë) ambiente :

- 1 (një) sallë mbledhjesh me kapacitet 30 – 35 persona, (të respektohen dimensionet e dyerve për numrin e propozuar të kapacitetit të sallës.
- 1 (një) ambient për serverin ,
- 2 (dy) laboratorë (një instrumental dhe një mekanik) si dhe
- 2 (dy) ambiente (një ambient për femra dhe një për meshkuj) të dedikuara për dhoma ndërrimi të pajisura me dushe (dy dushe për cdo ambient, gjithsej katër dushe) dhe tualete.

• Kati i parë

Hapësira e katit të parë do të organizohet në dy zona kryesore : *një zonë për qëllime shërbimi* ku do të vendosen dhomat e fjetjes, kantina dhe tualeti si dhe *një zonë* që do të shërbejë *për zyra* ku do të vendosen zyra e përgjegjës, si dhe tre zyra të tjera për kryerjen e funksioneve administrative.

Në katin e parë parashikohen gjithsej 8 (tetë) ambiente :

- 1 (një) zyrë për përgjegjësin e zyrës (manager – in e zyrës)
- 3 (tre) zyra për sistemin e stafit dhe kryerjen e funksioneve administrative

- 1 (një) ambient fjetje për meshkuj
- 1 (një) ambient fjetje për femra
- 1 (një) kantinë si dhe
- 1 (një) tualet

Në projekt do të parashikohen edhe kalimet e emergjencës (shkallët, koridoret). Numri dhe gjerësia e kalimeve të emergjencës duhet të sigurojnë largimin sa më të shpejtë dhe shfrytëzimi i tyre të nxjerrë në vend të sigurt jashtë ndërtesës me një rrugë të shkurtër, të shpejtë dhe pa rrezik.

Për përcaktimin e gjerësisë dhe gjatësisë së rrugëve të emergjencës, faktori kryesor është kohëzgjatja e largimit të personave nga objekti. Koha maksimale e largimit nga objekti në sekonda për çdo dhomë, mbas dhënies së sinjalit të alarmit duhet të jepet e llogaritur nga projektuesi.

3. MAGAZINË

Është menduar që të ndërtohet një objekt, ambientet e të cilit do të përdoren për qëllime magazinimi materiale. Sipërfaqja totale e magazinës është menduar të jetë rreth 400.00 m².

Ambienti i brendshëm duhet të jetë i lirë (pa kollona), dyshemeja me shtresë betoni për përballimin e ngarkesave të ndryshme. Godina duhet të përfshijë sistemet elektrike, hidraulike, mbrojtje nga zjarri, etj. Duke qënë se ambientet do të shfrytëzohen për magazinim dyshemeja duhet të jetë e tillë që të përballojë ngarkesat e ndryshme, rafteve të magazinimit dhe materialeve. Ndriçimi i ambientit do të sigurohet me ndriçim natyral (me qëllim rritjen e efikasitetit dhe kursimin e energjisë) dhe me ndriçim elektrik. Ambienti duhet të pajiset me dyer të daljes së emergjencës (numri i tyre në varësi të përmasave të objektit, një numër prej 20 personash të pranishëm në objekt dhe normave në fuqi) për secilin rast të vendoset dhe sinjalistika përkatëse.

4. SHESH (DEPOZITIMI) i jashtëm 1

Është menduar që në ambientin e jashtëm të krijohet hapësira e nevojshme për një shesh depozitimi me një sipërfaqe prej rreth 200-250 m². Parashikohet që sheshi të jetë i mbuluar. Funksioni i tij primar do të jetë depozitimi i materialeve të ndryshme si edhe për qëndrimin e përkohshëm të makinerive të rënda.

5. SHESH (DEPOZITIMI) i jashtëm 2

Shesh depozitimi të jashtëm me sipërfaqe rreth 50 m². Ky shesh i dytë do të shërbejë për depozitimin e mbeturinave.

6. PARKIME, RRUGË KALIMI, ZONA TË GJELBËRUARA

Në sipërfaqen e jashtme të lihet hapësira e nevojshme për rrugë kalimi, që të mundësohet hyrja e automjeteve dhe makinerive në ambientet e magazinave.

Për sipërfaqen e ambientit të jashtëm të realizohet rrethim transparent (kangjella, etj), rrethim i cili të garantojë të gjitha normat e sigurisë dhe standardeve për ndërtime të këtij lloji.

Në sipërfaqen e jashtme është menduar të lihet një hapësirë për:

- Parkim

parkim automjeteve të stafit (*Njësi 10-15*) i cili do të akomodohet aty por edhe të mjeteve më të mëdha (*Njësi 2-4*).

Shtresat rrugore të trajtohen të tillë që të sigurojnë garanci për qëndrueshmëri dhe të përballojnë kapacitetet faktike dhe ato të prespektivës.

- Rrugë kalimi

Në sipërfaqen e jashtme të krijohet hapësira për rrugë qarkullimi të brendshme që të lejojnë hyrjen në kompleks, aksesin në sheshe dhe daljen nga kompleksi të automjeteve të gjata plus hyrjen, parkimin dhe daljen e automjeteve të vogla.

Rrugë hyrje, dalje dhe qarkullimi të brendshëm këmbësorësh.

- **Ambiente të gjelbëruara**

Një pjesë e ambientit të jashtëm do të shërbejë për hyrjen në ndërtesën e zyrave, ndërsa pjesa tjetër do të përdoret për ambiente çlodhëse, prandaj rëndësi të veçantë ka edhe krijimi i një sipërfaqeje të gjelbëruar dhe me pemë.

Materialet që do të përdoren, të jenë sipas kushteve teknike të rrugëve.

Projektuesi do të duhet të hartoj paraprakisht:

Skemën e rrjetit rrugor

Hartimi i skemës shoqërohet me:

a. relacion teknik;

b. një analizë të situatës ekzistuese, në raport me efektet sociale që mund të sjellë projekti në drejtim të kosto-efektivitetit dhe te impaktit social, ekonomik, funksional dhe mjedisor.

Qëllimi i kësaj faze është që Projekti të ketë analizë të përputhshmërisë me planet, efikasitetin ekonomik të ndërhyrjes, pra efektivitet të koston, minimizim të impakteve negative sociale.

Skemën e qarkullimit/lëvizjes

Projektuesi duhet të hartojë dhe të paraqesë paraprakisht, së bashku me skemën e rrjetit rrugor edhe analizën dhe skemën e qarkullimit/lëvizjes. Kjo skemë duhet të jetë Fletë e veçantë e projektit.

Projekti/skema duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë:

- Aksesibilitetin për të gjitha kategoritë e mjeteve, duke përfshirë rastet dhe mjetet e emergjencës (sidomos ato të zjarrit, shendetit etj);

- Parashikimin e mënyrës së lidhjes së sheshit me ndërtesat, si dhe lidhjen e të gjithë strukturës me infrastrukturën e zonës;

- Aksesibilitetin e këmbësorëve;

- Aksesibiliteti i personave me aftësi të kufizuar;

- Të gjithë elementët e mësipërm të ndërthuren në një projekt sinjalizimi rrugor, si dhe duke siguruar një organizim të lëvizjes;

- Plotësimin e elementëve të sigurisë rrugore duke trajtuar me kujdes të gjithë elementët (kalimet këmbësore, këndet e shikimit, ndriçimi, etj.).

Të trajtohet në projekt mënyra e lëvizjes si dhe masat e sigurisë së këmbësoreve gjatë punës për realizimin e objektit në të gjitha fazat. Projektuesi duhet të paraqesi në fletë të vecanta të gjitha detajet e nevojshme të masave të sigurisë që do të reflektohen edhe në preventiv. Skema e rrjetit rrugor do të diskutohen me Specialistët e Albga Sh.a dhe vetëm pasi të marret miratimi përkatës, Projektuesi vazhdon me detajet.

Projektuesi duhet të konsultohet vazhdimisht me drejtorinë e Projekteve të Shoqërisë Albga Sh.a, përpara fillimit të punës për projektin, ashtu si edhe gjatë të gjitha fazave të projektimit dhe zbatimit të tij dhe kjo si për të garantuar saktësisë e të dhënave ashtu edhe për reflektimin e ndryshimeve të pritshme nqs ka të tilla.

7. KËRKESA TË PËRGJITHSHME PROJEKTIMI

Projektuesi duhet të kryejë të gjithë punën në përputhje me standartet e projektimit dhe ndërtimit që janë në fuqi në Shqipëri dhe me standartet më të mira Europiane. Ai duhet të hartojë një projekt zbatimi të qendrës së mirëmbajtjes duke përmbyllur kërkesat.

- Të përdoren studimet dhe të dhënat paraprake që disponohen nga Njësia Administrative, seksioni i urbanistikës dhe nga kadastra.
- Të merret në konsideratë drejtimi i zhvillimit urbanistik të zonës dhe të përshtatet studimi urbanistik për objektin (Qendra e Mirëmbajtjes Korçë) në përputhje me studimin urbanistik për të gjithë zonën.
- Cilësia e studimit duhet të jetë e tillë që të arrihet në standartin e kërkuar.
- Duhet të realizohet një studim urbanistik sipas standarteve të kërkuara për realizimin e ambienteve të kërkuara për porositësin në përputhje dhe përshtatje të plotë urbane, bazuar dhe në eksperiencat e ngjashme shqiptare apo botërore.
- Hyrja e objekteve, të parashikohen që të funksionojnë secila më vete.

8. KËRKESA TË VEÇANTA

- Projektuesi duhet të sigurojë azhurnimin e rrjeteve inxhinierike të infrastrukturës për objektin nga institucionet kompetente si dhe të sigurojë miratimin e projekteve elektrike në OSSHE.
- Gjatë projektimit të kihet parasysh VKM Nr.584, dt. 2.11.2000, "për kursimin e energjisë dhe ruajtjen e ngrohtësisë në ambiente".
- Dokumentacioni ligjor që shoqëron dosjen e paraqitur për leje sheshi dhe ndërtimi sipas formularëve përkates, azhurnimit të rrjeteve inxhinierike të infrastruktures, etj. (përveç konfirmimit të pronesisë së objektit që do të sigurohen nga Albgaz sh.a), do të përgatiten nga vetë projektuesi.
- Hartimi i Preventivit

Kosto totale e do të përcaktohet nga preventivi përfundimtar i objektit, që do të përgatitet bazuar në projektin e zbatimit, specifikimeve teknike duke marrë parasysh edhe kërkesat e veçanta në lidhje me standartet e pranuar.

Në hartimin e preventivit çmimet e referencës do të jenë sipas legjislacionit në fuqi (Manuali Teknik i Çmimeve V.K.M nr. 629, date 15.07.2015). Projektuesi duhet të paraqesë variantin më të mirë ekonomik të realizimit të projektit.

9. KËRKESA MBI KONDICIONET KONSTRUKTIVE DHE FUNKSIONALE.

- Për ndërtimin e objekteve të reja është e domosdoshme përcaktimi i vetive fizike dhe mekanike të dherave dhe masave gjeologjike që përcaktojnë terrenin ku parashikohet të ngrihen ndërtesat në fjalë.
- Gjatë hartimit të projekt-zbatimit duhet të kihet parasysh sa më poshtë: Të merret në konsideratë perspektiva 10 vjeçare e zhvillimit të zonës. Të kihet në konsideratë rrjeti ekzistues i kanalizimeve të zonës ku do të ndërtohet objekti, por gjithashtu konsulentit duhet të marrë në konsideratë projektin e ri të kanalizimeve për këto zona (nqs janë përgatitur). Rrjeti i shkarkimit të ujrave të zeza do të ndërtohet me materiale bashkëkohore dhe në përputhje me standartet në fuqi. Gjithashtu në bashkëpunim me shoqërinë e Ujesjellës – Kanalizime sh.a. të saktësohet edhe gjëndja e ujësjellësit ekzistues të zonës si dhe problemet

e vërejtura në këtë zonë gjatë periudhës së furnizimit me ujë duke përcaktuar edhe kapacitetin depozitues për furnizim me ujë tërëgjyeshëm pa ndërprerje gjatë ditës.

Projektuesi të parashikojë në projekt/preventivin e objektit, vlerën e furnizimit dhe vendosjes së linjës së furnizimit me ujë nga pika e marrjes së dhënë nga Ujësjellës –Kanalizime sh.a Korçë deri tek matësi i ujit.

- ***Ndërtimi dhe adaptimi i objekteve duhet të përfshijë edhe instalimin e ri elektrik.***

Konsulenti duhet të parashikojë ndriçimin e dhomave me ndriçues me fuqi të mjaftueshme për të garantuar një ndriçim në përputhje me normat në fuqi, dhe një numër të mjaftueshëm prizash për secilin ambient, sipas destinacionit të tyre.

Në rast se del e nevojshme që të ndërtohet kabinë, duhet të parashikojë projekt/preventivi i saj.

Projektuesi duhet të sigurojë Miratimin e projekteve elektrike në OSHEE sh.a, si dhe të përcaktojë edhe pikën e lidhjes me energji elektrike, nga rrjeti i fuqisë (kabina ose transformatori i zonës).

Projektuesi duhet të parashikojë vendosjen e matësit elektrik trefazor, lidhjen e kontratës me OSHEE si dhe vlerën e përafërt të shtrimit të kabllit nga sahati deri te pika e lidhjes së miratuar si dhe vlera e tarifave të OSHEE.

Projekti elektrik të jetë i shoqëruar me licensën e noteruar të inxhinierit elektrik, e cila do të shërbejë për procedurat e mëtejshme për miratimin e pikës së lidhjes me OSHEE.

Projektuesi duhet të parashikojë burime furnizimi alternative për të siguruar furnizim të pa ndërprerë me energji elektrike.

Në projekt-preventiv duhet të parashikohen edhe ndriçimi emergjencës, për rastet e ndërprerjes së energjisë elektrike.

- **Rrugët:**

Të parashikohet qarkullimi i lirshëm i mjeteve dhe këmbësoreve brenda territorit të qendrës së mirëmbajtjes, si dhe hyrjet/daljet në rrugën kryesore. Infrastruktura rrugore të shoqërohet me sinjalistiken e nevojshme vertikale dhe horizontale.

- **Sistemi i mbrojtjes nga zjarri (MNZ)**

Konsulenti duhet të paraqesë dhe projektin e mbrojtjes nga zjarri si dhe rregullat e sigurimit teknik për MNZ sipas normave dhe standarteve europiane.

- **Ambientet sanitare**

Konsulenti duhet të parashikojë ambiente sanitare të përshtatshme. Të sigurohet ujë i vazhdueshëm dhe i ngrohtë në lavamanë, për këtë arsye të shikohet mundësia e instalimit të boliereve si dhe realizimi i rrjetit të nevojshëm hidraulik. Banjo të jenë të ajrosura, të ndriçuara dhe të ventiluara. Kur s'ka ajrim direkt duhet të pajisen me impiant ajrimi dhe ventilimi.

Kollonat e shkarkimit të jenë të shkëputura nga kanalet e ventilimit, me ajrim në tarracë dhe shkarkimet të jenë të kontrollueshme.

- **Sistemimet e jashtme dhe ambientet e gjelbëruara**

Projektuesi duhet të përgatisë materialet e nevojshme për të përfshirë në projekt një mjedis të kompletuar me rrugica, sistem kullimi për territorin, mur rrethues duke përfshirë kënde të ndryshme rekreacioni. Përveç pjesës me asfalt ose beton rëndësi të veçantë ka krijimi i sipërfaqeve të gjelbërta dhe me pemë.

Projektuesi duhet të japë të detajuara shtresat përkatëse për sistemimin e sheshit si dhe teknologjinë e zbatimit të tyre, dhe të kombinojë ambientet e gjelbëruara me hyrjet për në ambientet e banimit.

Konsulenti duhet të parashikojë dhe ndriçimin e jashtëm të objekteve, në përputhje me planin urbanistik të kësaj zone dhe në përputhje me kërkesat e veçanta për rrjetin e ndriçimit të dhënë në këtë detyrë projektimi. Të merret në konsideratë ndriçimi i ambienteve të jashtme përreth banesave, perimetrit të rrethimit etj.

Për të mbajtur pastërtinë e shesheve duhet të vendosen kosha për mbeturinat.

- **Sigurimi i objektit:**

Projektuesi të parashikojë masat e nevojshme për të krijuar një ambient të sigurtë të mbrojtur nga kërcënimet e jashtme. Të parashikohet rrethimi në të gjithë perimetrin e kufirit të pronës, i cili të plotësojë kushtet e sigurisë të institucionit, të jetë i ndriçuar dhe i mbikëqyrur.

Për mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të parashikohet ndërtimi i një sistemi dixhital vëzhgimi, monitorimi e regjistrimi me kamera me cilësi të lartë në regjistrim dhe kapacitet ruajtës të lartë

- **Të tjera**

Në realizimin e projektit arkitektonik duhen patur parasysh dhe të gjejnë zbatimin e duhur të gjitha rregullat dhe normat urbanistike dhe arkitektonike për personat me aftësi të kufizuar PAK. Projektuesi duhet të parashikojë në projekt/preventiv edhe rampat për lëvizjet e personave me aftësi të kufizuar (PAK), sinjalistika për të verbrit etj.

Projektuesi gjithashtu duhet të sigurojë azhurnimin e rrjeteve inxhinierike të infrastrukturës për objektin, nga institucionet kompetente si dhe të sigurojë miratimin e projekteve elektrike në IQT - Inspektoriat Qendror Teknik.

Dokumentacioni ligjor që shoqëron dosjen e paraqitur për **leje sheshi dhe ndërtimi** sipas formularëve përkatës, azhurnimit të rrjeteve inxhinierike të infrastrukturës, etj (përveç konfirmimit të pronësisë së objektit dhe azhurnimit topografik që do të sigurohen nga autoriteti kontraktor), do të përgatiten nga vetë projektuesi.

Të përgatitet edhe një variant projekti për sistemet e ngrohjes alternative si dhe termoizolim të objektit sipas normave të reja dhe sipas VKM Nr.584, dt. 2.11.2000, “Për Kursimin e Energjisë dhe Ruajtjen e Ngrohtësisë në Ambiente”.

A. Rekomandime për projektuesin

- Projekti do të hartohet në bashkëpunim të ngushtë me specialistët e Sektorit të Projektve dhe Studimeve të Albgaz sha. Projektuesi duhet të përdori dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me zonën ku ndodhet trualli; sistemin ekzistues të largimit të ujërave, sistemin e furnizimit të zonës me ujë të pijshëm, sistemi ndriçues i jashtëm, distancat e lejuara si dhe kriteret urbane të zonës në fjalë.
- Projektuesi duhet të përdori studimet dhe të dhënat paraprake që disponohen nga Albgaz sha, si dhe ato të seksionit të Urbanistikës, kadastra e Bashkisë së qytetit të Korçës.
- Cilësia e projektimit duhet të jetë e tillë që të arrihet në standardin e kërkuar.

Standarde në Projektim

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standardet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standateve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e Projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standardeve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standareve të reja, për përafrimin me normat e BE-së, si dhe të praktikave më të mira ndërkombetare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elementë të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe vlerave limit për financimin e veprës.

Në hartimin e projektit të mbahen parasysh të gjitha normat e miratuar për personat me aftësi të kufizuar, të verberit, etj. Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori. Detajet teknike të infrastrukturës për këtë kategori, të jepen nga Projektuesi në Fletë të veçanta të Projektit.

Standarde në paraqitjen e dokumentacionit teknik

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, Projektuesi të përdori programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, më të avancuara të fushës.

Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të kihen parasysh dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji “Për urbanistikën”, Rregullorja e Urbanistikës dhe Legjislacioni në fuqi.

B. Realizimi i Projektit

Projekti i paraqitur për Realizimin e Studim – Projektimit për “Ndërtimin e Qendrës Së Mirëmbajtjes - Korçë” duhet të hartohet në përputhje me kërkesat e detyrës së projektimit dhe kushteve teknike të projektit të zbatimit.

Projekti përfundimtar do të përfshijë vizatimet për të gjitha punimet që do kryhen, specifikimet teknike për të gjitha punimet e parashikuara, relacionin përshkrues të punës për secilin prej punimeve dhe preventivin e punimeve të parashikuara.

Projekti do të jetë sipas standarteve të shtetit Shqiptar si dhe duhet të përmbajë (por jo të kufizohet):

Projekti Arkitektonik

Planvendosja e objektit
Plansistemimi i sheshit
Plani i gjelbërimit të sheshit
Planimetritë e propozuara teknike
Planimetritë e propozuara të mobilimit
Prerje gjatësore dhe tërthore
Fasadat e propozuara teknike
Fasadat e propozuara
Plani i kullimit të ujrave
Detaje të ndryshme arkitektonike

Projekti Hidraulik

Planimetritë e largimit të ujrave të shiut
Planimetritë e furnizimit me ujë
Planimetritë e shkarkimit të ujrave të zeza
Materialet e tubacioneve dhe komponentë impiantistikë në rrjetet e brendshme.
Detaje të këtyre tre sistemeve.

Projekti Ngrohje Ftohje

Planimetria e vendosjes së pompës së nxehtësisë
Planimetritë e vendosjes së pajisjeve ngrohjes-ftohjes
Planimetritë e shtrirjes së instalimeve
Detaje të ndryshme

Projekti Elektrik

Planimetritë e ndriçimit

Planimetritë e furnizimit me energji

Rrjeti i furnizimit me tension të mesëm TM dhe të ulët TU

Planimetritë e ndriçimit të emergjencës

Detaje të ndryshme dhe kriteret e nevojshme për instalimet.

Projekti i evakuimit dhe MKZ

Planimetritë e evakuimit dhe të instalimeve të MNZ – së.

Tabelat e emergjencave të jenë me ndricim

Sistemi i sinjalizimit të MKZ të jetë me dedektorë tymi dhe me sirenë alarmi

Planimetritë e vendosjes së shuarësve për çdo kat

Detaje të ndryshme

C. Llogaritjet, specifikimet teknike dhe preventivi.

Relacioni teknik që shoqëron projektin duhet të përmbajë:

- Raportin teknik të projektimit arkitektonik
- Raportin teknik të projektimit konstruktiv ku duhet të përfshihen përlllogaritjet
- Specifikimet Teknike të cilat duhet të jepen për çdo zë pune.
- Preventivi i plotë i kushtimit të veprës.

D. Paraqitja e vizatimeve.

Vizatimet në fazë projekt zbatimi duhet të paraqiten mundësisht në format A3, të jenë të lexueshme dhe të përmbajnë si minimum fletët si më poshtë:

- a) Topografinë e gjendjes ekzistuese në të cilën të jetë i azhurnuar ndërtimi në gjëndjen e sotme (me leje dhe pa leje)
- b) Planimetria e përgjithshme e objektit në Shk. 1:200; 1:500
- c) Planimetritë e objekteve të reja Shk. 1:100; 1:50
- d) Fasadat e reja në 2D dhe 3D Shk. 1:100
- e) Prerjet e godinës (në të dy drejtëmet) Shk.1:100
- f) Plani i strukturave, detaje Shk.1:100; Shk. 1:50
- g) Planimetritë e mobilimit Shk.1:100
- h) Planimetria e rrjetit të kanalizimeve në shkallën Shk. 1: 100
- i) Puseta dhe detaje të tjera të rrjetit të kanalizimeve Shk.1:10, 1:20
- j) Planimetria, skema e furnizimit me ujë në Shk. 1: 200, 1:100
- k) Planimetria dhe detaje të sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit Shk.1:100;
- l) Planimetri dhe detaje për ndriçimin, fiksimin e ndriçuesve në tavan, instalimin e kuadrit kryesor etj. Shk.1:100;1:50
- m) Planimetria e skemës së shpërndarjes së fuqisë në të gjithë objektin, Shk. 1:100
- n) Planimetria e ndriçimit të jashtëm dhe detaje të tij Shk.1:100; 1:50
- o) Planimetria e ambienteve të gjelbëruara dhe detaje Shk.1:100; 1:50
- p) Planimetria disiplinimit dhe shkarkimit të ujrave sipërfaqësore dhe detajet përkatëse shk.1: 100; 1:50

Në fletët e vizatimit të konstruksionit të objektit duhet të jepen dhe tabelat e specifikimit për çdo material, hekur, beton, tulla etj.

E. Raportimi

Raportet dhe dokumentat duhet të jenë në 5 (pesë) kopje, në gjuhën shqipe ku njëra nga kopjet të jetë e printuar me ngjyra. Vizatimet duhet të jenë të lexueshme në formatin “dwg” (autoCad 2007-2012). Të gjitha materialet do të dorëzohen edhe në soft-copy (në 4 CD).

Relacioni teknik që shoqëron projektin duhet të përmbajë:

- Raportin teknik të projektimit arkitektonik.
- Raportin teknik të projektimit konstruktiv ku duhet të përfshihet edhe raporti mbi llogaritjet për gjithë strukturat (themelet, shkallëve, soletave, arkitrarëve, trarëve, muraturës mbajtëse etj.) si dhe masat inxhinierike që janë parashikuar të merren, siguria e kalimit në objekt gjatë kryerjes së punimeve të ndërtimit. Në këtë raport do të bashkëngjiten dhe anekset përkatëse ku janë të gjitha llogaritjet përfshirë modelin kompjuterik të llogaritjeve për kontrollet eventuale nga ana e investitorit.
- Relacionin sizmiologjik të truallit (kur nuk ka studim, një përshkrim i përgjithshëm)
- Specifikimet Teknike.

F. Organizimi, plani i punës dhe stafi i kërkuar

Projekti do të hartohet në bashkëpunim të ngushtë me specialistët e Sektorit të Projektve dhe Studimeve të Alb gaz sha. Stafi duhet të përfshijë :

- 1 (një) Arkitekt
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet
- 1 (një) Gjeolog me orientim Gjeoteknik-Hidrogeologji
- 1 (një) Inxhinier Elektrik për Industri
- 1 (një) Inxhinier Mekanik Teknolog
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi për punime civile
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi, profili Strukturist
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik

I gjithë stafi i mësipërm/(inxhinierik) duhet të jetë i pajisur me licensë profesionale dhe USB (Token) përkatëse për nënshkrimin elektronik të projekteve.

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR³

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

³ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore.

Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme ☐

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	_____
Emri i plotë i shoqërisë	numri i NIPT-it

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____	_____
Emri i plotë i shoqërisë	numri i NIPT-it

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____	_____
Emri i plotë i shoqërisë	numri i NIPT-it

2. _____	_____
Emri i plotë i shoqërisë	numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e

shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____

2. _____

3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit: _____

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme ☐ çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15.

KUSHTET E PËRGJITHSHME
Shërbimet –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e shërbimeve të prokuruarra me anë të procedurës kërkesë për propozim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë, gjithashtu, Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 “Termat e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4 Praktikë Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autortiteti Kontraktues mund t'i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 5 Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premtonte ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6 Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t'i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
